- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbylljen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtjesit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

OBJEKTIVI I SHËRBIMIT PËR AMBIENTET E ALBCONTROL SHA

Ofrimi i shërbimit të pastrimit të përditshëm të ambienteve të brendshme të godinave të ALBCONTROL sh.a që ndodhen në Rinas, Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza”. Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme, duhet të ofrohet duke vënë në dispozicion fuqinë punëtore, mjetet, makineritë dhe materialet profesionale të pastrimit të kontraktuesit sipas kërkesave në vijim:

I. GODINA E ADMINISTRATËS

Sipërfaqet e ambienteve të brendshme të godinës së Administratës, janë si më poshtë:

1. Sipërfaqja e dyshemesë së zyrave (rezinë)	1303 m ²
2. Sipërfaqja e dyshemesë së korridoreve dhe shkallëve (rezinë)	596 m ²
3. Sipërfaqja e dyshemesë (parket)	40 m ²
4. Sipërfaqja e dyshemesë së lokalit (pllakë)	230 m ²
5. Sipërfaqja e dyshemesë së lokalit, veranda (pllakë)	80 m ²
6. Sipërfaqja e sallës së trajnimeve (rezinë)	132 m ²
7. Ndarja e zyrave (xham)	638 m ²
8. Sipërfaqja e dyshemesë ambjentet e Sigurisë (pllakë)	30 m ²
9. Sipërfaqja dyshemesë së tualeteve (13 tualete) (pllakë)	43 m ²
10. Sipërfaqja e dyshemesë së ambjenteve teknike (beton)	50 m ²
11. Fasada e jashtme	1002 m ²

II. Grafiku i Shërbimeve të pastrimit të ambienteve të brendshme:

Në këtë godinë shërbimi i pastrimit do të kryhet 5 (pesë) ditë të javës me sistem prej 1 (një) turn.

Shërbime me frekuencë ditore.

- Pastrimi, larja e dyshemesë së korridoreve dhe shkallëve.
- Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet, zyra dhe korridore).
- Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.
- Pastrimi i dollapëve, rafteve dhe mobilieve të tjera.
- Pastrimi i dyshemeve rezinë, pllakë, beton dhe parket në të gjithë ambientin.
- Pastrimi i WC-ve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre.
- Pastrimi i spërfaqes së ambientit bar-kafe.
- Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër dhe lëng/shkumë duarsh).
- Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.
- Pastrimi i ashensorëve.
- Pastrimi i dyerve hyrëse, dyert e emergjencave dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, arkiva, salla mbledhjeve etj.).
- Pastrimi i parmakëve inox të brendshëm.
- Pastrimi i zyrave, dyshemesë dhe mobilieve brenda tyre.
- Pastrimi i dyshemesë në perimetrin e godinës.

Shërbime me frekuencë periodike.

- Pastrimi i xhamave ndarës së zyrave (një herë në muaj)
- Pastrimi i fasadës (jashtë dhe brenda) (një herë në muaj)
- Pastrimi i ambjenteve teknike (depo e ujit, dhoma e kaldajes, dhoma e elektricistëve) (një herë në muaj)

2. GODINA E AKADEMISË

Sipërfaqet e ambienteve të brendshme të godinës së Akademisë, janë si më poshtë:

- | | |
|--|---------------------|
| 1. Sipërfaqja dyshemesë së zyrave (rezinë) | 150 m ² |
| 2. Sipërfaqja dyshemesë sallave të trajnimeve (rezinë) | 215 m ² |
| 3. Sipërfaqja e sallës teknike radarit (rezinë) | 238 m ² |
| 4. Sipërfaqja e sallës kontigjencës (rezinë) | 170 m ² |
| 5. Sipërfaqja dyshemesë korridoreve dhe shkallëve (rezinë) | 307 m ² |
| 6. Sipërfaqja dyshemesë tualeteve (8 tualete:) | 85 m ² |
| 7. Ndarja e zyrave (xham) | 188 m ² |
| 8. Fasada e jashtme | 1072 m ² |

Grafiku i Shërbimeve të pastrimit të ambienteve të brendshme:

Në këtë godinë shërbimi i pastrimit do të kryhet për 5 (pesë) ditë të javës me 1 turn.

Shërbime me frekuencë ditore.

- Pastrimi, larja e dyshemesë së korridoreve dhe shkallëve.
- Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualetet, zyra dhe korridore).
- Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.
- Pastrimi i dollapeve, raftëve dhe mobilieve të tjera.
- Pastrimi i WC-ve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre.
- Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër dhe lëng/shkumë duarsh).
- Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.
- Pastrimi i dymve hyrëse, dymet e emergjencave dhe dymet e ambienteve të brendshme (zyra, salla trajnimesh etj.).
- Pastrimi i parrakëve inox të brendshëm.
- Pastrimi i zyrave, dyshemesë dhe mobiljeve brenda tyre.
- Pastrimi i dyshemesë në perimetrin e godinës.

Shërbime me frekuencë periodike.

- Pastrimi i xhamave ndarës së zyrave (një herë në muaj)
- Pastrimi i fasadës (jashtë dhe brenda) (një herë në muaj)
- Pastrimi i sallave të trajnimeve (një herë në javë)
- Pastrimi i sallave teknike (radarit dhe kontigjencës) (një herë në javë)

3. MAGAZINA PRANË ADMINISTRATËS

Sipërfaqet e ambienteve të brendshme të Magazinës, janë si më poshtë:

1. Sipërfaqja e dyshemesë (rezinë)	400 m ²
2. Ndarja e zyrës (xham)	5 m ²
3. Fasada e jashtme (dritaret)	50 m ²

Grafiku i Shërbimeve të pastrimit të ambienteve të brendshme:

Në këtë godinë shërbimi i pastrimit do të kryhet 5 (pesë) ditë të javës me sistem prej 1 (një) turni.

Shërbime me frekuencë ditore.

- Pastrimi, larja e dyshemesë.
- Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave në zyrë.
- Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.
- Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.
- Pastrimi i dyshemesë në perimetrin e godinës.

Shërbime me frekuencë periodike.

- Pastrimi i fasadës së jashtme (dritaret) (një herë në muaj)

4. GODINA ACC DHE KULLA E TRAFIKUT AJROR

Sipërfaqet e ambienteve të brendshme të godinës së ACC dhe kulla e trafikut ajror, janë si më poshtë:

1. Sipërfaqja e dyshemesë së zyrave (rezinë)	2,500 m ²
2. Sipërfaqja e shkallëve dhe korridoreve (rezinë)	360 m ²
3. Sipërfaqja e dyshemesë së zyrave (parket)	350 m ²
4. Sipërfaqja e dyshemesë me tapet	400 m ²
5. Sipërfaqja e dyshemesë së tualeteve (16 tualete)	200 m ²
6. Sipërfaqja e dyshemesë së ambjenteve teknike dhe kondicionimit (beton)	600 m ²
7. Ndarja e zyrave (xham)	220 m ²
8. Fasada e jashtme (xham)	850 m ²

Grafiku i Shërbimeve të pastrimit të ambienteve të brendshme:

Në këtë godinë shërbimi i pastrimit do të kryhet për 7 (shtatë) ditë të javës me sistem 2 (dy) turnesh.

Shërbime me frekuencë ditore.

- Pastrimi, larja e dyshemesë së korridoreve dhe shkallëve.
- Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet, zyra dhe korridore).
- Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.
- Pastrimi i dollapëve, rafteve dhe mobilieve të tjera.
- Pastrimi i parketit dhe tapeteve.
- Pastrimi i WC-ve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre.
- Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër dhe lëng/shkumë duarsh).
- Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.

- Pastrimi i ashensorëve.
- Pastrimi i dyerve hyrëse, dyert e emergjencave dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, sallat e mbledhjeve etj.).
- Pastrimi i parmakëve inox të brendshëm.
- Pastrimi i zyrave, dyshemesë dhe mobiljeve brenda tyre.
- Pastrimi i dyshemesë në perimetrin e godinës.

Shërbime me frekuencë periodike.

- Pastrimi i xhamave ndarës së zyrave (një herë në muaj)
- Pastrimi i fasadës (jashtë dhe brenda) (një herë në muaj)
- Pastrimi i ambjenteve teknike (një herë në muaj)
- Pastrimi tapetit (një herë në 6 muaj)

5. LOKALI PRANË GODINËS SË ACC

Sipërfaqet e ambienteve të brendshme të Lokalit, janë si më poshtë:

- | | |
|--|--------------------|
| 1. Sipërfaqja e dyshemesë brenda (rezinë) | 200 m ² |
| 2. Sipërfaqja e dyshemesë veranda (beton) | 120 m ² |
| 3. Sipërfaqja e dyshemesë së tualeteve (2 tualete) | 13 m ² |
| 4. Fasada e jashtme (xham) | 179 m ² |

Grafiku i Shërbimeve të pastrimit të ambienteve të brendshme

Në këtë godinë shërbimi i pastrimit do të kryhet 7 (shtatë) ditë të javës me sistem 1 turni.

Shërbime me frekuencë ditore.

- Pastrimi, larja e dyshemesë dhe verandës.
- Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave për tualet.
- Pastrimi i tavolinave dhe karrigeve.
- Pastrimi i WC-ve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre.
- Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër dhe lëng/shkumë duarsh).
- Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.
- Pastrimi i dyerve hyrëse

Shërbime me frekuencë periodike.

- Pastrimi i fasadës (jashtë dhe brenda) (një herë në muaj).

6. SALLA VIP “MARUBI LOUNGE”

Sipërfaqet e ambienteve të brendshme të sallës VIP “MARUBI LOUNGE”, janë si më poshtë:

- | | |
|---|--------------------|
| 1. Sipërfaqja e dyshemesë së hollit (pllaka) | 120 m ² |
| 2. Sipërfaqja e dyshemesë së sallave (mokat + parket) | 380 m ² |
| 3. Sipërfaqja e veshjes së murit dhe dyer (druri) | 300 m ² |
| 4. Sipërfaqja e dyshemesë së tualeteve (10 tualete) | 50 m ² |
| 5. Fasada e jashtme | 172 m ² |

Grafiku i Shërbimeve të pastrimit të ambienteve të brendshme:

Në këto mjedise shërbimi i pastrimit do të kryhet për 7 (shtatë) ditë të javës me sistem 2 (dy) turne.

Shërbime me frekuencë ditore.

- Pastrimi, larja e dyshemesë.
- Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet dhe korridore).
- Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve mbi to.
- Pastrimi i rafteve dhe mobilieve të tjera.
- Pastrimi dhe larja e parketit me solucion të përshtatshëm.
- Pastrimi dhe larja e tapetit me solucion të përshtatshëm.
- Pastrimi i WC-ve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre.
- Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër dhe lëng duarsh).
- Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.
- Pastrimi i dyerve hyrëse, dyert e emergjencave dhe dyert e ambienteve të brendshme (sallat)
- Pastrimi i dyshemesë në perimetrin e godinës.

Shërbime me frekuencë periodike.

- Pastrimi i fasadës (jashtë dhe brenda) (një herë në muaj).

7. ZYRAT E BRIFING DHE KULLA KONTIGJENCËS

Sipërfaqet e ambienteve të brendshme të Brifing dhe kulla kontigjencës, janë si më poshtë:

- | | |
|--|-------------------|
| 1. Sipërfaqja e dyshemesë se zyrave (pllake) | 27 m ² |
| 2. Sipërfaqja e dyshemesë se tualeteve zyra briefing (2 tualete) | 10 m ² |
| 3. Sipërfaqja e dyshemesë se tualeteve kulla (1 tualet) | 4 m ² |
| 4. Sipërfaqja e shkallëve të kullës se kontigjencës | 40 m ² |
| 5. Sipërfaqja e xhamave te kullës | 50 m ² |

Grafiku i Shërbimeve të pastrimit të ambienteve të brendshme

Në këtë godinë shërbimi i pastrimit do të kryhet 6 (gjashtë) ditë të javës me sistem prej 1 (një) turni.

Shërbime me frekuencë ditore.

- Pastrimi, larja e dyshemesë.
- Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualetet dhe zyra).
- Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve mbi to.
- Pastrimi i rafteve dhe mobilieve të tjera.
- Pastrimi i WC-ve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre.
- Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër dhe lëng/shkumë duarsh).
- Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.
- Pastrimi i derës hyrëse.

Shërbime me frekuencë periodike.

- Pastrimi i xhamave (jashte dhe brenda) (një herë në muaj)
- Pastrimi i shkallëve te kullës. (një herë në javë)
- Pastrimi i Wc-së muret pllaka dyshemeja dhe dezifektimi i tyre (një herë në javë)

Evadimi i mbeturinave

Evadimi i mbeturinave nga kazanët e mbetjeve teknologjike do kryhet me kamion të mbyllur vetëngarkues/shkarkues të posaçëm për largimin e mbetjeve, nga ku ky proces do kryhet në 2 vendgrumbullime ku do jenë vendosur kazanët e mbetjeve teknologjike. Vendodhja e vendgrumbullimeve është tek;

1. Ambientet e jashtme të Godinës Administrative dhe tek,
2. Ambientet e jashtme të Godinës ACC.

Këto 2 vendgrumbullime janë të aksesueshme nga makinat/kamionët që do përdoren për evadimin e mbeturinave.

Në mënyrë të përmblodhur në formë tabelare po paraqesim listën e shërbimeve të kërkuara si më poshtë vijon;

**TABELË PËRMBLEDHËSE – GRAFIKU I KRYERJES SË SHËRBIMIT
TË PASTRIMIT TË AMBIENTEVE TË BRENDSHME.**

Nr.	Lloji i Shërbimit	Frekuenca e pastrimit
1	Pastrimi, larja e dyshemesë së korridoreve.	Çdo ditë
2	Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet, zyra dhe korridore), dhe shkarkimi i tyre në kazanët teknologjikë.	Çdo ditë
3	Evadimi i mbeturinave nga kazanët e mbetjeve teknologjike me kamion të mbyllur vetëngarkues/shkarkues.	2 herë në javë
4	Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.	Çdo ditë
5	Pastrimi i dollapeve, rafteve dhe mobilie të tjera.	Çdo ditë
6	Pastrimi i moketeve parketeve dhe tapeteve	Çdo ditë
7	Pastrimi i dyshemeve, industriale, me pllaka, parketi dhe beton të të gjitha ambienteve.	Çdo ditë
8	Pastrimi i WC-ve, aksesoreve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre brenda dhe jashtë.	Çdo ditë
9	Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.	Çdo ditë
10	Pastrimi i verandave të lokaleve	Çdo ditë
11	Pastrimi i ashensorëve.	Çdo ditë
12	Pastrimi i dyerve hyrëse, dyert e emergjencave dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, magazina, arkiva, sallat e mbledhjeve, salla trajnimesh etj.).	Çdo ditë
13	Pastrimi i parmakëve inoks të brendshëm.	Çdo ditë
14	Pastrimi i zyrave, dyshemesë dhe mobiljeve brenda tyre.	Çdo ditë

15	Pastrimi i dyshemesë përpara derës hyrëse në ambientit e brendshëm në godinë.	Çdo ditë
16	Pastrimi i ambienteve teknike (salla kontigjencës, radarit)	Çdo javë
17	Pastrimi i Sallave të trajnimeve dhe Sallës së Mbledhjeve.	Çdo javë
18	Pastrimi i ambienteve të shërbimit	Çdo javë
19	Pastrimi i ambienteve teknike që shërbejnë për Panelet Elektrike, Bateri, Depo e Ujit, Dhomat e Serverave, kondicionimin, pastrim dyshemeje dhe merimangat.	Një herë në muaj
20	Pastrimi Arkivës.	Një herë në muaj
21	Pastrimi i xhamave ndarës të zyrave	Një herë në muaj
22	Pastrimi i fasadës.	Një herë në muaj
23	Shërbim me Deratizim.	Një herë në muaj
24	Shërbim me Dezinfektim, Dezinsektim	8 herë në vit

****Përveç Shërbimeve sipas grafikut të mësipërm do të kryhen shërbime pastrimi të tjera, në kushte të jashtëzakonshme në funksion të mirëmbajtjes ditore të ambienteve të brendshme.***

PUNONJËSIT E SHËRBIMIT:

Kontraktuesi për kryerjen e Shërbimit duhet të ketë punonjësit e nevojshëm. Për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme, duhet të vihen në dispozicion të paktën **12** (pesëmbëdhjetë) **punonjës pastrimi**; 7 për turnin e parë dhe 3 për turnin e dytë, si dhe 2 punonjës do jenë për pastrim larje fasadash dhe duhet të jenë të trajnuar dhe të pajisur me certifikate të punimeve në lartësi të lëshuara nga shoqëri të licensuara nga ministria përkatëse. Lidhur me punonjësit e pastrimit për vetë natyrën e punës së tyre me kohë të plotë, ne si A.K. gjykojmë që O.E. duhet të ketë të punësuar të paktën **15 punonjës pastrimi** nga ku **3 punonjës të jenë si zëvendësues** në rast mungesash eventuale të punonjësve të pastrimit. Krahas punonjësve të pastrimit, kontraktuesi duhet të sigurojë edhe 1 (një) Përgjegjës Shërbimi me kohë të plotë, i cili duhet të mbikëqyrë punën e të gjithë punonjësve, dhe do të jetë pikë kontakti midis kontraktuesit dhe autoritetit kontraktor dhe të jetë në dispozicion të autoritetit kontraktor për çdo kërkesë apo problematikë që mund të lindë. Punonjësit e pastrimit, gjatë kohës së shërbimit duhet të jenë të veshura me uniformën e kontraktuesit, e cila duhet të jetë gjatë gjithë kohës e pastër dhe e rregullt.

Kontraktuesi duhet të disponojë një Autokullë vinç në lartësi mbi 20 metra për larjen e fasadave të jashtme, dhe për këtë duhet të ketë të punësuar **1 drejtues/manovrator** të pajisur me dëshmi/leje për manovrimin e autokullës/vinç për pastrimin e fasadave të jashtme

Gjithashtu kontraktuesi duhet të disponojë një kamion të mbyllur vetëngarkues/shkarkues për evadimin e mbeturinave për në pikën e grumbullimit të mbetjeve, duke ndjekur në vazhdimësi procesin e riciklimit të mbetjeve si dhe një automjet transporti për punonjësit dhe materialet e pastrimit (kjo

kërkesë bëhet për shkak se ALBCONTROL sha është kompani e certifikuar me standartin ISO 14001:2015). Për kamionin e evadimit të mbeturinave si dhe automjetin e transportit të punonjësve dhe materialeve Kontraktuesi duhet të ketë **të paktën edhe 1 drejtues automjeti të punësuar** të pajisur me dëshmitë/leje drejtimi përkatëse sipas kategorisë/ llojit të automjetit.

ORARET E KRYERJES SË SHËRBIMIT:

- **Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme tek Godina e ACC – Kulla e Kontrollit si dhe tek SALLA VIP “MARUBI LOUNGE” do të kryhet nga dita e Hënë deri të Dielën, në 2 turne, me oraret si më poshtë:
Turni I: 07:00’ – 15:00’.
Turni II: 15:00’ – 21:00’.**
- **Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme tek LOKALI PRANË GODINËS SË ACC do të kryhet nga dita e Hënë deri të Dielën, me 1 turn, si më poshtë:
Turni I: 07:00’ – 15:00’.**
- **Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme tek ZYRAT E BRIFING DHE KULLA KONTIGJENCËS do të kryhet nga dita e Hënë deri të Shtunën, me 1 turn, si më poshtë:
Turni I: 07:00’ – 15:00’.**
- **Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme tek Godina Administrative dhe ambienteve të tjera do të kryhet nga dita e Hënë deri të Premten, me 1 turn, me orarin si më poshtë:
Turni I: 07:00’ – 15:00’. Tek kjo kategori objektsh përveç ditës së shtunë dhe të dielë edhe në ditët e javës që bien ditë pushimi për administratën për shkak të festave zyrtare ky shërbim nuk do kryhet.**

Punonjësit e të dyja turneve, duhet të fokusohen në pastërtinë e korridoreve dhe ambienteve të përbashkëta dhe tualeteve (pastrimi i dyshemesë, zëvendësimi i qeseve të koshave të mbeturinave, letrave të duarve, letrave higjienike) etj.

Punonjëset e turnit të parë duhet të përqendrohen në mirëmbajtjen e ambienteve të përbashkëta, korridoreve, tualeteve, ashensorëve, pastrimin e hyrjeve, Magazinave, Sallat e trajnimeve. Kontrollimi i pastërtisë së tualeteve duhet të bëhet periodikisht (të paktën çdo 60 minuta).

MATERIALET E PASTRIMIT:

Për një përlllogaritje sa më të saktë mbi sasinë e nevojshme të materialeve të pastrimit për përdorim personal (sapun i lëngshëm për larje duarsh, letra higjienik, letra duarsh etj.) sqarojmë se numri i punonjësve në ambientet ku do kryhet shërbimi i pastrimit është jo më shumë se 350 persona. Për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme të godinave ALBCONTROL, nga Kontraktori duhet të vihen në dispozicion materiale shumë cilësore, për shkak të vetë cilësisë së lartë të strukturës së brendshme. Ato nuk duhet të jenë gërryes dhe duhet të jenë në të njëjtën kohë pastrues dhe higjienizues. Kontraktori duhet të vejë në dispozicion (por pa u kufizuar në to) materiale të tilla si: kosha të vegjël për zyra, korridore, tualete, qese mbeturinash, detergjent për pastrim dyshemeje (i cili duhet të jetë sipas llojit përkatës të dyshemesë), detergjent për pastrim tapeti, materialet e konsumit (letër higjienike, letër duarsh, sapun lëng/shkumë), lecka mikrofibër për marrjen e pluhurave, shtupa të posacme për tualete, lecka për fshirje në të thatë, solucion për pastrim pajisjesh informatike, solucion për pastrim ashensorësh, set për larjen e xhamave, karela pastrimi, fshesa korenti etj.

Detergjentët që duhet të vihen në dispozicion duhet të jenë të një cilësie të lartë, dhe duhet të kenë specifikimet teknike të përshkruara si vijon:

1	Solucion zbardhues dhe dezinfektues banjosh	Litër
2	Solucion larës pllakash	Litër
3	Solucion për larje xhamash	Copë
4	Solucion për pastrim mobiliesh	Copë
5	Sapun i lëngshëm për larje duarsh	Litër
6	Lecka mikrofibër	Copë
7	Klor për larje dysHEMEJE	Litër
8	Shtupa/lecka për larje	Copë
9	Peceta të zakonshme pastrimi	Copë
10	Qese mbeturinash 70x85 cm, 70 litra	Pako
11	Qese mbeturinash 100x75 cm, 100 litra	Pako
12	Kova plastike për larje	Copë
13	Letra higjienike	Pako
14	Letra duarsh	Copë
15	Aromë ambienti	Copë
16	Mbajtëse letre për duar	Copë
17	Mbajtëse sapuni i lëngshëm për duar	Copë
18	Aromatik banjo	Litër
19	Solucion larës parketi	Litër
20	Acid për pastrim banjosh	Litër
21	Acid për zhbllokim banjosh	Litër

1. Solucion zbardhues, që përdoret për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve, veshjeve porcelani, hidrosanitareve. Të heqë pikat e bardha të ujit. Të përdoret dhe për larjen e pllakave të poshtme të tualeteve me hollim minimum nga 1-150 në 1-200 me ujë. Masat nga 1 litër deri në 10 litra. Të jenë linja profesionale. Niveli i PH-(1-2).
2. Solucion për larje pllakash dysHEMEJE. Të jetë sa më i koncentruar (1-200 me ujë), të lërë arome të lehtë pas larjes. Të jetë prodhim me standarde të EU dhe i certifikuar sipas standeteve. Të ketë kartat e sigurisë dhe të përbërjes. Masat nga 1 deri në 10 litra. Të jenë linja profesionale. Niveli i PH – (8+/-5%).

-
3. Solucion për larje xhamash (me spray). Të jetë prodhim me standardet të EU, dhe të çertifikuar, të kenë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Masa të jetë 500-800 ml me spray. Të jetë linjë profesionale. Niveli i PH – (8.5-9).
 4. Solucion për larje mobiljesh (me spray) 500 ml. Të çertifikuara, të kenë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Të jetë linjë profesionale. Niveli i PH – (8-9).
 5. Sapun lëng/shkumë për duar. Amballazhimi të jetë në bidona nga 3 deri në 5 litra. Të jetë i çertifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe të përbërjes. Të jetë antibakterial, të ketë arome të lehtë. Niveli i PH (6+/5%).
 6. Peceta për pastrim pluhurash me mikrofibra (tip peshqiri) me përmasa 30x30.
 7. Klor për larje dysHEMEJE, të jetë paketim 1 litër.
 8. Tufa (shtupa) për larje dysHEMEJE, mikrofibër, 100% ekologjike të plota. Fijet të jenë në shirita me përmasa 25x4 cm +/- 2 cm, të mbushura plot.
 9. Peceta të zakonshme pastrimi, set me 3 deri në 5 copë. Përmasa 18x20 cm, ngjyra të ndryshme, materiali sungjerte 100%. Fibër natyrale.
 10. Qese mbeturinash (qeset të jenë plastike, rezistente, me përmasa 70x85 cm, me kapacitet 70 litra dhe të jenë antibakteriale. Një pako të përmbajë 10 prerje.)
 11. Qese mbeturinash (qeset të jenë plastike, rezistente, me përmasa 100x75 cm, me kapacitet 100 litra dhe të jenë antibakteriale. Një pako të përmbajë 10 prerje.)
 12. Kova plastike për larje dysHEMEJE, me vend për shtrydhje tufe. Të jenë shumë rezistente dhe praktike. Të ketë të etiketuar në pamjen e jashtme shenjën e kujdesit kapacitet 12-14 litra. Prodhim i verifikuar sipas standarteve EU. Me përmasa 35x26x35 cm.
 13. Letër higjienike në paketa jo më pak se 10 rula. (2 shtresa, me këputje, 1 top me 135 ndarje.) Letra të ketë ngjyrë të bardhë. Duhet që produktet e brendit të kenë çertifikatë kualiteti ku të përshkruhet që materiali është i padëmshëm për shëndetin e njeriut. Përmasat e një topi të jenë diametri 10 cm dhe lartësia 9,5 cm.
 14. Letër për fshirje duarsh, 2 shtresa, ngjyrë e bardhë, që vendosen në aparatet e tyre, me paketim jo më pak se 270 fije, me përmasa 21x22 cm, të jetë cilësore. Produkti duhet të jetë i çertifikuar me çertifikatë kualiteti ku të përshkruhet që është i padëmshëm për shëndetin e njeriut.
 15. Aromatizues ambientesh bombola (për zyra). Të përmbajë 5% surfaktanti jo-jonik, parfum, acid laktik.
 16. Dispensera letra duarsh zig-zag, të kenë përmasa 270 mm x 410 mm x140 mm, të jenë cilësi e lartë.
 17. Mbajtëse sapuni i lëngshëm për duart që vendoset në mur.
 18. Aromatik banjo ambalazh me pika (pllaka, pileta, hidrosanitare). Paketim 1 litër. Të ketë skede teknike.
 19. Solucion për larje parketi. Paketim 1 litër, hollimi 1:200 L ujë. Gjithashtu paketimi të jetë i pajisur me dozatorin përkatës. Të jetë produkt i çertifikuar.

20. Pastrues me bazë acidi klorhidrik për papastërti të forta.

21. Zbllokues për tualete, lavamane, dushe dhe bide. Të largojë të gjithë mbetjet organike dhe inorganike që mund të bllokojnë tubat.

Produktet 1, 2, 3, 5, 13, 14, 18, 19, të jenë të pajisura nga Prodhuesi me Çertifikatë Sigurie.

Në rast se materialet e pastrimit nuk janë të një cilësie të lartë, nuk do të pranohen nga AK.

Kontraktuesi duhet të bëjë furnizimin me materiale e detergjentë pastrimi dhe mirëmbajtje duke pasur parasysh ambientet e Autoritetit Kontraktues.

Furnizimi me materiale pastrimi duhet të bëhet sipas një itinerari të caktuar apo sipas nevojave dhe konsumimit, nën kujdesin e Përgjegjës të Shërbimit të Kontraktuesit i cili duhet të bëjë shpërndarjen e tyre dhe të sigurojë që mos të mungojë asnjëherë furnizimi.

Tualetet e brendshme të godinave dhe të ambienteve të jashtme të saj janë si më poshtë:

- Tualet 52 copë, nga ku 44 copë janë WC dhe 8 copë janë ambiente për larjen e duarve.

Pastrimi i dyshemesë rezinë industriale

Dyshemeja e përdorur për shtrimin e ambienteve tona përbëhet shumica nga rezin industriale. Rezina mbron shtresën nën të nga dëmtimi, ofron higjienë shumë të lartë, dhe ambient pune të sigurtë. Për pastrimin e dyshemesë rezine duhet të përdoret një detergjent ndër më cilësorët. Ajo duhet të jetë e një cilësie shumë të mirë, për të shmangur çdo dëmtim apo gërvishtje të dyshemesë. Punonjësi, i cili do të kryejë shërbimin e larjes së dyshemesë duhet ta njohë mjaft mirë përdorimin e solucionit dhe makinerisë, jo vetëm për të kryer një shërbim efikas pastrimi, por edhe për të shmangur ndonjë dëmtim apo gërvishtje të dyshemesë.

Dyshemeja me pllaka:

Për pastrimin e dyshemesë me pllaka rekomandohet ujë i pastër dhe pastrues neutral. Punonjësi duhet të përdor një përzierje uji dhe një sasi të caktuar pastruesi neutral për të pastruar pllakat e dyshemesë. Gjithashtu duhet shmangur përdorimi i agentëve të pastrimit që janë acid, gërryes ose shumë të fortë.

Dyshemeja e betonit:

Për pastrimin e dyshemesë së betonit duhet të përdoren produkte me pH neutral. Ajo është shumë poroze, pra thith shumë shpejt ndotjen. Njollat, si ato të vajit, eliminohen me vështirësi. Gjatë kalimit të kohës prodhon pluhur, nga ku mundësia për të vazhduar me një trajtim ndaj njollave dhe ndaj pluhurit vështirësohet. Probleme të veçanta vijnë nga varieteti i komponentëve të panjohur.

Sipërfaqja e Parketit:

Papastërtia dhe pluhuri nuk ngjiten dhe mund të pastrohen lehtë duke mundësuar dhe garantuar një ambient higjienik dhe antialergjik. Për pastrimin e tij duhet të përdoren produkte natyrore me përmbajtje biokarbonati, që mundëson heqjen e njollave. Për pastrimin e parketit përdoret solucion parketi, në raportin gjysmë litri solucion i holluar në 5 litra ujë. Ky solucion duhet të jetë i parrezikshëm për shëndetin, të përmbushë dhe garantojë standartet në përdorimin e tij.

KRYERJA E SHËRBIMIT DDD:

Për kryerjen e shërbimit DDD, do të jetë e nevojshme të merren masat e mëposhtme:

- Masa kundër mushkonjave – larvave.
- Masa kundër mizave që lidhen me ndotje fekale në afërsi.
- Masa kundër gjarpërinjve dhe zvarranikëve.
- Deratizimi.

Luftimi i insekteve fluturake:

Mushkonjat: Për shkak të nivelit të pushtave dhe të qëndrimit të ujit në to, është konstatuar zhvillimi i larvave, që duhen dominuar me larvicid Diflubenzuron (trajtime 2 – 3 javore), ose me Bti + Bsph që përdoren edhe në zonën bregdetare. Trajtimet duhet të fillojnë në fillim të muajit Mars dhe deri në fund të muajit Tetor.

Mizat e fekaleve:

Duhet të trajtohen me insekticid me pompë. Eliminimi i vatrës ku zhvillohen është mjeti më i mirë, por duke qenë se kjo gjë është e pamundur, duhet të vazhdojë trajtimi mujor me insekticid të fuqishëm, për shkak të rezistencës që paraqesin.

Largimi i gjarpërinjve:

Infestimi nga gjarpërinjtë ndodh në pjesë të ndryshme të territorit, si zonë me gjarpërinj. Megjithatë duhet mbajtur gjithë territori i gjelbëruar i objekteve të ALBCONTROL. Për këtë do të përdoren:

Repellent per Reptile RR-2 është një mjet miqësor me njeriun dhe mjedisin për trajtimin e infektimeve me zvarranikë. Zvarranikët janë shumë të ndjeshëm ndaj vibracioneve. Ata po ashtu i ndjejnë dridhjet e brendshme të tokës jashtëzakonisht mirë. RR-2 e kthen atë në avantazhin e vet. Prodhon një zhurmë vibruese çdo 30 sekonda. Emisionet e tingujve janë frikësuese ndaj zvarranikëve dhe më në fund i trembin ato. Pajisja është tërësisht e padëmshme për njerëzit dhe kafshët shtëpiake. Repellent per Reptile RR-2 është efektive edhe kundër disa brejtësve të tokë si moles / Talpa Europea, L. / dhe mol-rats / Spalax Leucodon / s. Sipërfaqja efektive e pajisjes është rreth 800m² ose afërsisht një rreth me diametër 35m. Duhet të kontrollohet rregullisht nëse pajisja funksionon, nëse ka tinguj të dukshëm ose dridhje. Për performancën optimale të pajisjes, duhet të vendoset në zonën që ndihmon për të prishur strehëzat e reptilëve.

Këto mjete do të jenë prezentë nga Muaji Mars deri në fund të muajit Tetor. Sipërfaqet që do të mbulohen, përfshirë zonën jashtë objektit, në hyrje, pranë depove të ujit.

Monitorimi dhe dokumentacioni:

- Deratizim, monitorim të paktën 1 herë në muaj, zëvendësim produkti në rast konsumi.
- Luftimi i insekteve – mushkonjat. Trajtime mujore me larvicid.
- Mizat e fekaleve, trajtime 1 mujore.
- Largimi i gjarpërinjve, trajtime gjatë (Mars – Tetor).

Të gjitha shërbimet më sipër do të kryhen më shpesh në raste të shfaqjes së problemeve apo kërkesave.

Kalendar i shërbimeve DDD:

Shërbimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Përmbledhje
Deratizim	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	12 muaj
Dezinsektim	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	12 muaj
Largim gjarpërinjsh			X	X	X	X	X	X	X	X			8 muaj

Vendet që do të kryhet shërbimi DDD :

Vendet që do të kryhet shërbimi DDD do të jenë si më poshtë:

- Godina e administratës
- Godina e akademisë
- Magazina pranë administratës
- Godina ACC dhe kulla e trafikut ajror
- Lokali pranë godinës së ACC
- Salla VIP “Marubi Lounge”
- Zyrat e brifing dhe kulla kontigjencës
- Radari në Porto Romano

Në mënyrë përmbledhëse për kryerjen e gjithë këtyre shërbimeve nevojiten makineritë profesionale për ofrimin e shërbimit të pastrimit si më poshtë vijon:

Makina larëse e dyshemesë – lavasciuga:

Makina larëse e dyshemesë është një element shumë i rëndësishëm i mirë organizimit dhe mbarëvajtjes së pastrimit të ambienteve të brendshme. Ajo duhet të jetë e një cilësie shumë të mirë, për të shmangur çdo dëmtim apo gërvishtje të dyshemesë me përbërje të ndryshme pasi janë shumë delikatë. Punonjësi i cili do të kryejë shërbimin e larjes së dyshemesë me makineri lavasciuga duhet ta përdorë shumë mirë makinerinë.

Autokullë vinç:

Autokullë vinç në lartësi mbi 20 metra për larjen e fasadave të jashtme. Rrotullimi i platformës të jete 360° të vazhdueshme. Koshi duhet të jetë i montuar në krahun e vinçit (i pa çmontueshëm).

Godinat e ALBCONTROL sh.a. është e rrethuar nga lulishte. Lartësia e godinës varion nga 12 metra deri në 20 metra në pjesën ballore. Referuar përllogaritjeve të mësipërme për të kryer shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit të përditshme të ambienteve të brendshme, të jashtme dhe të gjelbërta të godinës së ALBCONTROL, krahun e vinçit duhet të jetë mbi 22 metra.

Makineritë profesionale për ofrimin e shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbeturinave:

- Kamion i mbyllur vetëgarkues/shkarkues për evadimin e mbeturinave nga kazanët e mbetjeve teknologjike 1 copë
- Makineri larëse e dyshemesë 2 copë
- Autokullë vinc 1 copë
- Makineri thithëse pluhrash dhe lëngjesh 2 copë

- <i>Makineri larje-tharje</i>	<i>1 copë</i>
- <i>Pompa dezinfektimi</i>	<i>1 copë</i>
- <i>Mjete transporti për punonjësit dhe mallrat</i>	<i>1 copë</i>
- <i>Kazan mbetjesh teknologjik</i>	<i>10 copë</i>
- <i>Kosha të vegjël mbeturinash</i>	<i>10 copë</i>
- <i>Karroca profesionale për shërbimin e pastrimit</i>	<i>6 copë</i>

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të ALBCONTROL”

Afatet e ekzekutimit: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

GRAFIKU I KRYERJES SË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT TË AMBIENTEVE TË BRENDSHME.

Nr.	Lloji i Shërbimit	Frekuenca e pastrimit
1	Pastrimi, larja e dyshemesë së korridoreve.	Çdo ditë
2	Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet, zyra dhe korridore), dhe shkarkimi i tyre në kazanët teknologjikë.	Çdo ditë
3	Evadimi i mbeturinave nga kazanët e mbetjeve teknologjike me kamion të mbyllur vetëngarkues/shkarkues.	2 herë në javë
4	Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.	Çdo ditë
5	Pastrimi i dollapeve, rafteve dhe mobilieve të tjera.	Çdo ditë
6	Pastrimi i moketeve parketeve dhe tapeteve	Çdo ditë
7	Pastrimi i dyshemeve, industriale, me pllaka, parketi dhe beton të të gjitha ambienteve.	Çdo ditë
8	Pastrimi i WC-ve, aksesoreve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre brenda dhe jashtë.	Çdo ditë
9	Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.	Çdo ditë
10	Pastrimi i verandave të lokaleve	Çdo ditë
11	Pastrimi i ashensorëve.	Çdo ditë
12	Pastrimi i dyerve hyrëse, dyert e emergjencave dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, magazina, arkiva, sallat e mbledhjeve salla trajnimesh etj.).	Çdo ditë
13	Pastrimi i parmakëve inoks të brendshëm.	Çdo ditë
14	Pastrimi i zyrave, dyshemesë dhe mobiljeve brenda tyre.	Çdo ditë
15	Pastrimi i dyshemesë përpara derës hyrëse në ambientit të brendshëm në godinë.	Çdo ditë
16	Pastrimi i ambienteve teknike (salla kontigjencës, radarit)	Çdo javë

17	Pastrimi i Sallave të trajnimeve dhe Sallës së Mbledhjeve.	Çdo javë
18	Pastrimi i ambienteve të shërbimit	Çdo javë
19	Pastrimi i ambienteve teknike që shërbejnë për Panelet Elektrike, Bateri, Depo e Ujit, Dhomat e Serverave, kondicionimin, pastrim dysHEMEJE dhe merimangat.	Një herë në muaj
20	Pastrimi Arkivës.	Një herë në muaj
21	Pastrimi i xhamave ndarës të zyrave	Një herë në muaj
22	Pastrimi i fasadës.	Një herë në muaj
23	Shërbim me Deratizim.	Një herë në muaj
24	Shërbim me Dezinsektim, Dezinsektim	8 herë në vit

****Përveç Shërbimeve sipas grafikut të mësipërm do të kryhen shërbime pastrimi të tjera, në kushte të jashtëzakonshme në funksion të mirëmbajtjes ditore të ambienteve të brendshme.***

TABELË PËRMBLEDHËSE

Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
1	Pastrimi i sipërfaqeve të ambienteve të brendshme 9,743 m ² , sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës si dhe materialet e pastrimit dhe furnizimeve.	m ²	1			
2	Pastrimi i sipërfaqeve dhe ndarjeve të brendshme (strukturë xhami) 1,051m ² x2 (nga dy anët), sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës si dhe materialet e pastrimit dhe furnizimeve.	m ²	1			
3	Sipërfaqe në total për shërbimin DDD 16,485 m ² , sipas specifikimeve dhe termave të referencës.	m ²	1			
4	Shërbimi i largimit të gjarpërinjve (8 herë në vit)	herë	1			
5	Sipërfaqe e fasadës së jashtme 3,375 m ² , x2 (nga dy anët) sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës.	m ²	1			
6	Evadimi i mbeturinave nga kazanët e mbetjeve teknologjike me kamion të mbyllur vetëngarkues/shkarkues sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës.	herë	1			
Çmimi në total pa TVSH për 1 vit						
Çmimi në total pa TVSH për 3 vjet						

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të ALBCONTROL”.

Detyrat: Sipas Specifikimeve Teknike dhe Termave të Referencës – SHTOJCA 6

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve Teknike dhe Termave të Referencës – SHTOJCA 6

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Sipas Specifikimeve Teknike dhe Termave të Referencës –
SHTOJCA 6

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
